

---

Truen sh.p.k

**RAPORTI I DHENIES SE SIGURISE I EKSPERTIT KONTABEL TE REGJISTRUAR**

Mbi shumat e detyrimeve te shoqerise "Truen" sh.p.k  
per ortakun **CN'AIR SAS**, qe do te perdoret per shlyerjen e kontributit  
me qellim te zmadhimit te kapitalit te shoqerise "Truen" sh.p.k  
si dhe per zvogelimin e kapitalit te shoqerise duke mbuluar humbjet e mbartura me 31 dhjetor 2022.

**mazars**

# Permbajtja

---

## PERMBAJTJA:

RAPORT I DHENIES SIGURISE I AUDITUESIT TE PAVARUR.....	3
PASQYRA E LLOGARITJEVE TE KUOTAVE TE KAPITALIT PER EFEKTE TE ZMADHIMIT DHE ZVOGELIMIT TE KAPITALIT THEMELTAR.....	5
SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE PER QELLIM TE ZMADHIMIT TE KAPITALIT THEMELTAR.....	8
1. Te dhena te Pergjithshme mbi Shoqerine .....	8
2. Te Dhena Per Zmadhimin e Kapitalit .....	8
3. Politikat Kontabel Per Pasqyrimin e Huave ne Pasqyrat Financiare .....	8

## RAPORT I DHENIES SIGURISE I AUDITUESIT TE PAVARUR

Drejtuar:

ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE SHOQERISE

“Truen”shpk

### Qellimi i Angazhimit:

Asambleja e ortakeve të shoqërisë me vendim të datës 01.12.2023 na ka angazhuar si auditues ligjor për të verifikuar dhe për të dhënë siguri të arsyeshme mbi përgatitjen dhe paraqitjen me vërtetësi të shumave dhe mundësive të zmadhimit të kapitaleve të veta duke përdorur si burim konvertimin e huasë kundrejt ortakut CN' AIR në kapital themeltar. Gjithashtu asambleja e ortakeve të shoqërisë na ka angazhuar si auditues ligjor për të dhënë siguri të arsyeshme mbi përgatitjen dhe paraqitjen me vërtetësi të shumave të zvogelimit të kapitaleve të veta për të mbuluar humbjet e mbartura.

### Kriteret

Si baze për angazhimin e verifikimit të zmadhimit të kapitalit në kemi përdorur Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, Ligjin Nr.25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, Ligjin “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë “Truen”sh.p.k, të periudhës kontabël të mbylluar më 31 dhjetor 2022, janë audituar, keto pasqyra financiare janë përdorur në angazhimin tonë.

Ortaku CN' AIR i ka dhënë financime Shoqërisë “Truen”sh.p.k, e cila me date 04.12.2023 paraqitet në vlerën 2,596,000 Euro, ose 267,758,062.96 Leke me kursin 103.14 Leke/Eur, sipas Bankes Kombëtare Tregtare.

Me date 31.12.2022 humbjet e mbartura të shoqërisë janë në shumën 302,716,740 Leke. Në kushtet kur rritja e kapitalit prej 267,758,062.96 Leke është e pamjaftueshme për të mbuluar gjithë humbjen e mbartur me date 31.12.2022 prej 302,716,740 Leke, zvogelimi i kapitalit do të bëhet në masën 267,758,062.96 Leke dhe humbja e mbartur do të mbetet në vlerën 34,958,677.04 Leke.

Në jemi njohur me Vendimin e asamblese të shoqërisë për miratimin në parim të zmadhimit dhe zvogelimit të kapitalit.

### Pergjegjësia e Drejtimit

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare në përputhje me kriteret e sipërpërmendura. Kjo përgjegjësi përfshin: përcaktimin, ushtrimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare të cilat nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve; zgjedhjen dhe zbatimin e primeve të duhura kontabile; dhe kryerjen e çmuarjeve kontabile të arsyeshme për rrethanat financiare.

### Pergjegjësia jonë

Pergjegjësia jonë është që ne përputhje me Vendimin e Asamblese se Ortakeve të datës 01.12.2023, bazuar në procedurat e kryera, të shprehim një opinion mbi shumën e detyrimit të shoqërisë Shoqërisë “Truen” ndaj ortakut CN' AIR në 04.12.2023.

Në e kryem auditimin në pajtim me Standardet Nderkombëtare të Angazhimeve të Dhenies se Sigurise (SNAS 3000) “Angazhimet të dhenies se Sigurise që ndryshojnë nga Auditimet apo rishikimet e Informacioneve Financiare Historike” dhe standardet e tjera që lidhen me çështjen në fjalë. Keto standarde kërkojnë që ne të planifikojmë dhe të kryejmë procedurat e nevojshme për të siguruar një nivel sigurie të arsyeshme që informacionet të përgatitura nga drejtimi i shoqërisë për kapitalet e veta janë të vërteta dhe të sinqerta, në të gjitha aspektet materiale.

## Procedurat e kryera nga ana jone per këtë angazhim perfshijne:

1. Verifikimin e perputhshmerise se shifrave ne pasqyren e Detyrimit per Ortakun CN'AIR me ato te Pasqyrave financiare te vitit ushtrimor te mbyllur me 31 dhjetor 2022 si edhe gjendja e detyrimit deri ne 04.12.2023.
2. Verifikimin e mjaftueshmerise se huase se dhene nga ortaku CN'AIR per te shlyer kontributin per zmadhimin e kapitalit te shoqerise "Truen"sh.p.k.
3. Verifikimin e llogaritjeve pas zvogelimit te kapitalit si pasoje e perthithjes se pjesshme te humbjes deri me 31.12.2022

## Konkluzioni

1. Bazuar ne procedurat e verifikimeve te kryera, shuma e huase kundrejt ortakut CN'AIR me 04.12.2023 kembyer me kursin e kembimit sipas Banka Kombetare Tregtare me date 04.12.2023 eshte si me poshte:

	<u>Shuma e Detyrimit ne Euro</u>	<u>Shuma e Detyrimit ne Leke</u>
Gjendja e detyrimit ne 04.12.2023	<u>2,596,000</u>	<u>267,758,062.96</u>

Keto shuma rakordojne me llogaritë përkatëse dhe dokumentacionin mbështetës që ne verifikuam. Pasqyra Financiare e Detyrimit, per qellim te zmadhimit te kapitaleve te veta te shoqerise, si dhe shenimet e lidhura me to, japin nje paqyrim të sinqertë dhe te vertete te gjendjes qe ortaku CN'AIR i ka dhene shoqerise Truen shpk.

2. Shuma e huase se dhene nga ortaku CN'AIR eshte e mjaftueshme per te shlyer kontributin e CN'AIR per zmadhimin e kapitalit ne masen 267,758,062.96 leke.
3. Llogaritja e vlerës së kuotës per secilin ortak, sipas "Pasqyra e llogaritjeve të vlerës së kuotave të reja pas zmadhimit të kapitalit të nënshkruar" pasqyron me vërtetësi efektet sipas vendimit e asamblesë date 01.12.2023 për qëllime të rritjes së kapitalit.
4. Llogaritja e vlerës së kuotës per secilin ortak, sipas "Pasqyra e llogaritjeve të vlerës së kuotave të reja pas zvogelimit të kapitalit të nënshkruar" pasqyron me vërtetësi efektet sipas vendimit e asamblesë date 01.12.2023 për qëllime të zvogelimit të kapitalit.
5. Mbas rritjes se kapitalit me ane te konvertimit te detyrimit kundrejt ortakut ne kapital dhe zvogelimit te tij me ane te perthithjes se pjesshme te humbjeve te mbartura deri me 31.12.2022, paraqitja e kapitaleve te veta eshte si me poshte:

	<u>Vlera e kuotave me 04.12.2023</u>	<u>Nr i kuotave</u>	<u>%</u>
Ortaku CN'AIR	40,957,128	1	93.08%
Ortaku Ylliad	3,042,872	1	6.92%
<b>Total</b>	<b>44,000,000</b>	<b>2</b>	<b>100.00%</b>

Diana YLLI (GOLEMI)

Me respekt



Auditues Ligjor

# mazars

Emin Duraku Str., Binjaket Build.,  
No.5, 1013, Tirana, Albania  
NUI: K32123006W

Tirane, me 05 dhjetor 2023

## PASQYRA E LLOGARITJEVE TE KUOTAVE TE KAPITALIT PER EFEKTE TE ZMADHIMIT DHE ZVOGELIMIT TE KAPITALIT THEMELTAR.

	<u>Shuma e</u>		<u>Shuma e</u>		
	<u>Detyrimit ne Euro</u>		<u>Detyrimit ne Leke</u>		
Gjendja e detyrimit ne 04.12.2023	<u>2,596,000</u>		<u>267,758,062.96</u>		
KAPITALET E VETA TE SHOQERISE	Totali i Kapitaleve te Veta 31.12.2022	Zmadhimi i kapitalit	Totali i Kapitalit pas zmadhimit	Zvogelimi i kapitalit	Totali i Kapitalit pas zvogelimit
Kapitali i nenshkruar	44,000,000	267,758,063	311,758,063	(267,758,063)	44,000,000
Rezervat ligjore			-		
Fitime/humbje te mbartura	(302,716,740)		(302,716,740)	267,758,063	(34,958,677)
Fitime/humbje neto 2023					
<b>TOTALI</b>	<b>(258,716,740)</b>	<b>267,758,063</b>	<b>9,041,323</b>	<b>-</b>	<b>9,041,323</b>

Llogaritjet per zmadhimin e kapitalit te shoqerise


		Shuma ne Leke	Numri i kuotave
Kapitalet e veta ekzistuese	=	44,000,000	2
Shtesa e kapitalit ne 04.12.2023	+	267,758,063	-
<b>Kapitali i shoqerise pas zmadhimit</b>	=	<b>311,758,063</b>	<b>2</b>


Llogaritjet per zvogelimin e kapitalit te shoqerise

		Shuma ne Leke	Numri i kuotave
Kapitali themeltar ekzistues	=	311,758,063	2
Zvogelimi i kapitalit ne 04.12.2023	+	(267,758,063)	
<b>Kapitali i shoqerise pas zvogelimit</b>	=	<b>44,000,000</b>	<b>2</b>

% qe zoteron secili ortak ne kapital

	Vlera e kuotave me 31.12.2022		Rritja e kapitalit	Vlera e kuotave pas rritjes		Zvogelimi i kapitalit	Vlera e kuotave pas zvogelimit	
		%			%			%
Ortaku CN'AIR	22,440,000	51.00%	267,758,063	290,198,063	93.08%	(249,240,935)	40,957,128	93.08%
Ortaku Ylliad	21,560,000	49.00%	-	21,560,000	6.92%	(18,517,128)	3,042,872	6.92%
<b>Total</b>	<b>44,000,000</b>	<b>100.00%</b>	<b>267,758,063</b>	<b>311,758,063</b>	<b>100.00%</b>	<b>(267,758,063)</b>	<b>44,000,000</b>	<b>100.00%</b>

Hartoi  
  
 Ekonomist

Miratoi  
  
 Menaxher i Pergjithshem  


## **SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE PER QELLIM TE ZMADHIMIT TE KAPITALIT THEMELTAR**

### **1. Te dhena te Pergjithshme mbi Shoqerine**

Shoqëria "TRUEN" sh.p.k është regjistruar pranë QKB me datë 17/04/2012 me NIPT L21617015E.

Organizimi dhe funksionimi i saj rregullohet sipas ligjit nr. 9901 dt 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare".

Veprimtaria kryesore tregtare e Shoqërisë është planifikimi, projektimi, financimi, ndërtimi, testimi, transferimi, funksionimi dhe mirëmbajtja e një Hidrocentrali të ndërtuar në lumin Truen, në Rrethin e Pukës, në Shqipëri ("Projekti Truen"), si dhe shitjen e energjisë së prodhuar prej tij.

### **2. Te Dhena Per Zmadhimin e Kapitalit**

Per realizimin e aktivitetit te saj shoqeria gjate dhe para vitit ushtrimor ka detyrime per ortakun e saj shoqerine "CN'AIR.

Ortaket e shoqerise me qellim realizimin e objektit te aktivitetit te shoqerise kane vendosur te rrisin kapitalin e shoqerise nepermjet perfshirjes ne kapital te detyrimit qe shoqeria i ka deri ne date 04.12.2023, perkatesisht ne shumen 267,758,062.96 leke per ta perdorur per shlyerjen e aksioneve te reja qe do te emetohen nga shoqeria. Si dhe zvogelimin e kapitalit nepermjet perthithjes se humbjeve te mbartura ne vleren 267,758,063 Leke.

Per kete qellim Asambleja e aksionareve me vendimin me date 01.12.2023, ka marre vendimin per zmadhimin e kapitalit.

### **3. Politikat Kontabel Per Pasqyrimin e Huave ne Pasqyrat Financiare**

#### **1.1. Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

#### **1.2. Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

#### **1.3. Biznesi në vijimësi**

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

#### **1.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.